

- NGA: Qendra “Res Publica”, organizatë jofitimprurëse e regjistruar si person juridik me vendimin nr. 604, datë 13.04.2010 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, z. Dorian Matlija, me adresë: Bulevardi “Gjergj Fishta”, Nd. 24, H. 3, Ap. 7, Tiranë.
- DREJTUAR: Kryetarit të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Z. Erion Bani
- LËNDA: Kërkesë për rishikimin dhe shfuqizimin e dispozitave të Rregullores së Brendshme që cenojnë aksesin e medias dhe lirinë e shtypit

I nderuar Z. Kryetar,

Qendra Res Publica, në kuadër të programeve të saj për mbrojtjen e lirisë së shprehjes, lirisë së medias dhe të drejtave të gazetarëve, ka shqyrtuar dispozitat e Rregullores së Brendshme “Për sigurinë, rendin, solemnitetin dhe rregullat e sjelljes në ambientet e Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar”, miratuar me vendimin nr. 49, datë 17.07.2026 të Këshillit të Gjykatës.

E kuptojmë dhe mbështesim nevojën që Gjykata, veçanërisht për shkak të natyrës së çështjeve që shqyrton, të ketë rregulla të qarta për sigurinë, rendin dhe zhvillimin normal të seancave. Megjithatë, disa prej dispozitave të Rregullores shkojnë dukshëm përtej këtij qëllimi dhe ndërhyjnë drejtpërdrejt në aksesin e gazetarëve në gjykimet publike, mbledhjen e informacionit dhe ushtrimin e veprimtarisë gazetareske.

Në vlerësimin tonë, këto dispozita ngrenë probleme serioze në raport me nenet 17, 22 dhe 23 të Kushtetutës, nenin 10 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, si dhe standardet e posaçme të Këshillit të Evropës mbi raportimin mediatik të procedimeve penale.

1. Akreditimi nuk mund të bëhet kusht për të ndjekur një seancë publike

Rregullorja krijon një sistem akreditimi të gazetarëve dhe më pas e lidh ndjekjen e seancave publike me statusin e *përfaqësuesit të medias të pajisur me akreditim*.

Një gjë është akreditimi si mjet organizativ që mund të krijojë lehtësi praktike për median dhe krejt tjetër është shndërrimi i tij në parakusht për aksesin e gazetarit në një seancë që, sipas ligjit, është publike.

Ky sistem krijon probleme të veçanta edhe për gazetarët e pavarur (freelance) si dhe format e reja të gazetarisë që nuk veprojnë domosdoshmërisht mbi bazën e një autorizimi të lëshuar nga një subjekt tradicional mediatik.

Në këtë drejtim, Parimi 12 i Rekomandimit Rec(2003)13 të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës është veçanërisht i qartë, që gazetarët duhet të pranohen në seancat publike dhe në shpalljen publike të vendimeve pa diskriminim dhe **pa kërkesa paraprake akreditimi**.

2. Gazetarit i kërkohet praktikisht të dijë sot se çfarë do të jetë lajm nesër

Neni 93 i Rregullores kërkon, si rregull, që gazetari që dëshiron të ndjekë një seancë të paraqesë kërkesën jo më vonë se 24 orë përpara.

Kjo kërkesë nuk përputhet me natyrën e gazetarisë dhe veçanërisht me raportimin e lajmit të ditës.

Interesi publik për një çështje mund të lindë disa orë përpara seancës, ose mund të zhvillohen seanca urgjente për masa sigurimi, ose mund të ndryshojë kalendari, ose mund të ndodhë një zhvillim i paparashikueshëm që e kthen një proces në lajm.

Kapaciteti fizik i sallës mund dhe duhet të administrohet, por publiciteti i seancës nuk mund të shndërrohet në një sistem rezervimi paraprak, ku gazetari duhet të ketë parashikuar një ditë më parë se çfarë do të jetë me interes publik ditën tjetër.

3. Një intervistë në holl nuk duhet të kërkojë lejen e Kryetarit të Gjykatës

Veçanërisht shqetësuese janë dispozitat që i nënshtrojnë autorizimit paraprak filmimet, fotografimet dhe intervistat në holl, si dhe parashikimet e Aneksit nr. 1 që ndalojnë, pa autorizim, *dhënien e deklaratave publike dhe zhvillimin e aktiviteteve mediatike* në ambientet publike.

Sigurisht që Gjykata mund të vendosë rregulla për të mos bllokuar korridoret, për të mbrojtur dëshmitarët, të miturit, personat me identitet të mbrojtur apo privatësinë e pjesëmarrësve. Por kjo është krejt tjetër nga vendosja e rregullit se një gazetar duhet të marrë lejen e Kryetarit të Gjykatës për të intervistuar dikë apo që një avokat, palë ose person tjetër të japë një deklaratë për median në një ambient publik të Gjykatës.

Në këtë pikë Rregullorja nuk administron më sigurinë e godinës, por vetëm rregullon vetë procesin e mbledhjes së informacionit nga media.

4. Telefoni dhe laptopi janë mjete pune të gazetarit, jo sende të rrezikshme

Një problem tjetër serioz lidhet me ndalimin e pajisjeve elektronike në sallën e gjykimit. Neni 93/16 i Rregullores parashikon se përfaqësuesit e medias që autorizohen të ndjekin seancën duhet të qëndrojnë në vendet e përcaktuara “pa mbajtur ose përdorur telefona celularë, kamera, aparate fotografike ose pajisje të tjera elektronike”, përveç rasteve të parashikuara shprehimisht

në Rregullore. Po kështu, Aneksi nr. 3 e shtrin shprehimisht ndalimin e mbajtjes dhe përdorimit të telefonave celularë edhe ndaj përfaqësuesve të medias.

Ndërkohë, Rregullorja njihet se laptopi është mjet pune për prokurorët, të pandehurit, viktimat dhe avokatët, të cilëve u lejohet përdorimi i tij për ushtrimin e funksioneve procedurale. Gazetarët janë lënë jashtë këtij përjashtimi.

Ky dallim është i vështirë për t'u justifikuar. Për gazetarin e sotëm, telefoni celular dhe laptopi janë mjete elementare pune. Ato përdoren për mbajtjen e shënimeve, konsultimin e dokumenteve, kërkimin e informacionit, komunikimin me redaksinë dhe përgatitjen ose përcjelljen e lajmit në kohë reale. Ndalimi i regjistrimit audio, fotografimit ose transmetimit pa leje është një çështje, por ndalimi i vetë mbajtjes së mjetit të punës është një çështje krejt tjetër.

Këtu duhet bërë dallimi ndërmjet posedimit të pajisjes dhe mënyrës së përdorimit të saj. Nëse përdorimi konkret cenon rendin, solemnitetin, privatësinë ose zhvillimin normal të seancës, është kryesuesi i seancës që duhet të ketë kompetencën ta kufizojë ose ta ndalojë, sipas rrethanave konkrete. Një ndalim administrativ absolut, i vendosur paraprakisht dhe i zbatuar në derën e sallës, nuk lejon asnjë vlerësim të tillë proporcionaliteti.

Ekzistojnë edhe modele shumë më pak kufizuese brenda vetë sistemit gjyqësor shqiptar. Gjykata Kushtetuese, në Rregulloren e saj për komunikimin me median, u lejon shprehimisht gazetarëve të dërgojnë mesazhe të shkruara nga pajisjet mobile gjatë seancës, me kusht që funksionet e zërit të jenë të çaktivizuara. Vetëm nëse ky komunikim pengon zhvillimin normal të seancës, Kryetari mund ta kufizojë ose ndalojë. Ky është pikërisht modeli proporcional, ku telefoni lejohet, zilha dhe sjellja shqetësuese jo, ndërsa kufizimi konkret mbetet në dorën e autoritetit që drejton seancën.

Edhe praktika e Gjykatës së Lartë ndjek një qasje ku mbajtja e telefonit në vetvete nuk trajtohet si shkak për përjashtimin e gazetarit nga salla, ndërsa respektimi i solemnitetit sigurohet përmes kufizimit të përdorimit shqetësues të pajisjes.

Siguria dhe solemniteti mund të garantohen duke kërkuar që telefonat të mbahen pa zile, të mos përdoren për regjistrim ose fotografim pa autorizim dhe duke i dhënë kryesuesit kompetencën të ndërhyjë kur përdorimi konkret pengon procesin. Nuk është e nevojshme që, për të garantuar heshtjen në sallë, gazetarit t'i merret telefoni që para se të hyjë në të.

5. Gjykata nuk duhet të kontrollojë edhe imazhin përmes të cilit publiku sheh gjykimin

Nuk vëmë në diskutim kompetencën e trupit gjykues për të vendosur, në një rast konkret, nëse lejohen kamerat apo regjistrimi gjatë seancës. Edhe standardet e Këshillit të Evropës pranojnë se regjistrimi dhe transmetimi nga salla mund t'i nënshtrohen kufizimeve për mbrojtjen e procesit dhe të personave të përfshirë.

Por neni 157 i Rregullores shkon më tej, duke parashikuar që, pasi sistemi audioviziv i Gjykatës të jetë funksional, regjistrimi i seancave publike të kryhet vetëm nga vetë Gjykata, ndërsa medias t'i jepet sinjali ose pjesë nga materiali i prodhuar prej saj.

Këtu krijohet një problem tjetër, që nga kontrolli i rendit në sallë kalojmë te mundësia që institucioni që po raportohet të kontrollojë materialin vizual përmes të cilit publiku e sheh atë. Kjo është veçanërisht e papranueshme për proceset me interes të lartë publik.

6. Një rregullore sigurie nuk mund të bëhet kod editorial për median

Edhe më problematike bëhen dispozitat që ndërhyjnë në mënyrën se si materiali i siguruar përdoret ose publikohet nga media.

Mbrojtja e privatësisë, prezumimit të pafajësisë, të miturve apo personave të cënueshëm është detyrim ligjor dhe konventor. Por kufizimet ndaj publikimit duhet të kenë bazë ligjore, qëllim legjitim dhe të kalojnë testin e domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit në rrethanat konkrete.

Një rregullore e miratuar për sigurinë dhe rendin e një gjykate nuk mund të shndërrohet në një instrument që përcakton përgjithësisht si duhet ta përpunojë apo publikojë media informacionin pasi e ka marrë atë.

Ju kujtojmë se Gjykata administron gjykimin, por jo redaksitë e lajmeve.

7. Pezullimi ose revokimi i akreditimit krijon një efekt të fortë frenues

Neni 98 i Rregullores parashikon masa që shkojnë nga paralajmërimi deri te pezullimi për disa muaj apo revokimi i akreditimit.

Garancitë procedurale të parashikuara në këtë nen, të tilla si arsyetimi, administrimi i provave dhe dëgjimi i gazetarit, nuk e zgjidhin problemin themelor, që mbi bazën e rregullave të hartuara nga vetë Gjykata, gazetari mund të humbasë për muaj me radhë mundësinë praktike për të mbuluar veprimtarinë e po asaj Gjykate.

Kur një masë e tillë lidhet me rregulla të gjera për pajisjet, regjistrimin, publikimin apo aktivitetin mediatik, këto dispozita krijojnë pashmangshmërisht një *chilling effect* (efekt frenues) mbi raportimin.

GJEDNJ ka theksuar edhe në çështjen *Pinto Coelho k. Portugalisë* (nr. 2) se sanksionimi i një gazetari për përdorimin e materialit nga një proces gjyqësor kërkon një vlerësim real të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit, dhe se zbatimi mekanik i një ndalimi nuk është i mjaftueshëm për qëllimet e nenit 10 të Konventës.

Për sa më sipër, Qendra Res Publica ju kërkon që, në cilësinë e Kryetarit të Gjykatës, të vini në lëvizje Këshillin e Gjykatës për rishikimin e menjëhershëm të Rregullores dhe, në veçanti:

- të rishikohen nenet 90, 92 dhe 93/1 të Rregullores, në mënyrë që akreditimi të mos shërbejë si kusht për hyrjen e gazetarëve në seancat publike, por vetëm si instrument lehtësues dhe organizativ për aksesin e rregullt të medias, ku neni 90 rregullon procedurën dhe kushtet e akreditimit, ndërsa neni 93/1 e lidh të drejtën për të ndjekur seancat publike me përfaqësuesit e medias “të pajisur me akreditim”.

- të shfuqizohet ose riformulohet neni 93/3, i cili kërkon paraqitjen e kërkesës për ndjekjen e seancës jo më vonë se 24 orë përpara, duke e kufizuar regjistrimin paraprak vetëm në rastet e posaçme kur ekziston një nevojë konkrete organizative, e argumentuar me të dhëna mbi kapacitetin, sigurinë ose interesin e lartë publik, dhe, nëse në praktikë nuk ekziston mungesë kapaciteti, gazetarët duhet të lejohen të ndjekin seancën edhe pa regjistrim paraprak. Vetë neni 93/2 e lidh aktivizimin e procedurës së administrimit të aksesit me ekzistencën e një nevojë konkrete, ndërsa pika 3 e shtrinë kërkesën 24 orëshe në mënyrë të përgjithshme.
- të shfuqizohet neni 57/2, si dhe parashikimet përkatëse të Aneksit nr. 1, në pjesën ku intervistat, deklaratat publike dhe veprimtaritë e zakonshme mediatike në ambientet publike të Gjykatës i nënshtrohen autorizimit paraprak të Kryetarit të Gjykatës ose personit të autorizuar prej tij;
- të rishikohen nenet 76, 77 dhe 93/16, si dhe Aneksi nr. 3, në pjesën që ndalon në mënyrë të përgjithshme mbajtjen e telefonave celularë dhe pajisjeve të tjera elektronike nga përfaqësuesit e medias dhe që nuk u njeh gazetarëve as përjashtimin për përdorimin e laptopëve si mjete pune; të adoptohet një regjim ku gazetarëve t'u lejohet mbajtja dhe përdorimi i telefonave dhe laptopëve për nevoja profesionale, me pajisjet në modalitet pa zë dhe pa regjistrim, fotografim ose transmetim të paautorizuar, duke i lënë kryesuesit të seancës kompetencën për të kufizuar përdorimin e tyre kur kjo është konkretisht e nevojshme për rendin, solemnitetin, privatësinë ose zhvillimin normal të procesit. Si model mund të merret rregullimi i Gjykatës Kushtetuese, i cili lejon përdorimin e pajisjeve mobile nga gazetarët me zërin të çaktivizuar dhe ia rezervon Kryetarit kufizimin e tyre vetëm kur përdorimi pengon seancën.
- të rishikohen nenet 95/8, 95/9 dhe 157/3, të cilat i japin Gjykatës kontroll të gjerë mbi regjistrimin dhe materialin audioviziv të seancave publike. Veçanërisht, neni 157/3 parashikon që, pas vënies në funksion të sistemit zyrtar audioviziv, regjistrimi i seancave publike mund të realizohet vetëm nga Gjykata dhe medias mund t'i vihet në dispozicion sinjali ose vetëm pjesë të regjistrimit;
- të rishikohen neni 96/3, veçanërisht gërmat “e” dhe “g”, si dhe neni 97, në masën në të cilën këto dispozita kalojnë nga rregullimi i sigurisë dhe mbrojtja e personave në përcaktimin e mënyrës se si media duhet të përpunojë ose publikojë materialin e mbledhur. Kufizimet editoriale duhet të rrjedhin nga ligji, kodi etik i medias ose nga një vendim konkret gjyqësor dhe jo nga një rregullore administrative e Gjykatës;
- të rishikohet neni 98, veçanërisht pikat 3-7, i cili parashikon pezullimin e akreditimit deri në gjashtë muaj dhe revokimin e tij për kategori të caktuara shkeljesh, në mënyrë që sistemi i sanksioneve të mos shndërrohet në një mjet për kufizimin afatgjatë të aksesit të gazetarit në Gjykatë për shkak të ushtrimit normal të profesionit.

Deri në përfundimin e këtij rishikimi, do të ishte e përshtatshme që zbatimi i dispozitave më kufizuese të pezullohej, veçanërisht aty ku ato mund të pengojnë aksesin në seanca publike ose veprimtarinë normale gazetareske.

Një gjykatë, dhe aq më tepër një gjykatë që shqyrton çështje me interes të jashtëzakonshëm publik, nuk duhet ta konsiderojë median si një problem sigurie që duhet administruar, por si

një nga mjetet përmes të cilave realizohet vetë publiciteti i drejtësisë. Rregullat e sigurisë duhet të mbrojnë gjykimin, por jo izolojnë atë nga publiku.

Res Publica shpreh gatishmërinë për të marrë pjesë në çdo proces konsultimi me Gjykatën, organizatat e gazetarëve dhe aktorët e tjerë të interesuar, me synim hartimin e një regjimi që garanton njëkohësisht sigurinë, procesin e rregullt ligjor dhe standardet e lirisë së medias.

Me respekt,

Tiranë, 07.09.2026

Qendra Res Publica
Drejtore Ekzekutive
Av. Dorian Matlija